Funded by
the European Union

COVID-19 si pretekst për lidhje emergjente të kontratave në prokurim publik (II)

Nëntor, 2021

SUNDIMI I LIGJIT

AUTOR:
Arbelina Dedushaj
Egzona Kozhani

Vizito webfaqen tonë
www.dplu.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit, lajmeve dhe infografikave online.

Find us on Facebook
@democracyplus

Find us on Facebook
@democracy-plus

Find us on Twitter
@democracy_plus

Find us on Youtube
@Democracy Plus

Zyra Jonë:

Rruga Tirana Blloku C/4/1, Hyrja C,
Kati VIII, Nr. 83/84
Prishtinë 10000, Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus-ks.org

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjera, pa lejen e D+.

Deklaratë mohimi:
Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.
Projekti "Kontribut në gjetjen e shkeljeve në prokurim publik të institucioneve në luftën kundër pandemisë COVID-19" i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).

Funded by
the European Union

Democracy
Plus

Përmbajtja

Shkurtesat 6

Hyrje 7

Tenderi 1: Shërbime funerale COVID-19 8

Tenderi 2: Furnizim me pajisje personale mbrojtëse kundër COVID-19 10

Tenderi 3: Blerja e dezinfektuesve për nevojat e shkollave të Kosovës 14

Tenderi 4: Blerja e maskave mbrojtëse për nxënësit në kushte pandemie 17

Tenderi 5: Furnizim me pajisje mbrojtëse kundër COVID-19 18

Tenderi 6: Furnizim me material për mbrojtje nga COVID-19 në zgjedhjet lokale 20

Tenderi 7: Furnizim me mjete mbrojtëse kundër COVID-19 20

Tenderi 8: Furnizim me material higjienik kundër COVID-19 për institucionet publike 22

Tenderi 9: Furnizim me miell për familjet në kushte të rënda ekonomike të shkaktuara nga pandemia 23

Tenderi 10: Furnizim me pako ushqimore/higjienike për familjet në kushte të rënda ekonomike të shkaktuara nga pandemia 24

Rekomandime 27

Shkurtesat

AK →	Autoriteti Kontraktues
ASK →	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK →	Administrata Tatimore e Kosovës
DT →	Dosja e Tenderit
GEO →	Grupi i Operatorëve Ekonomik
KQZ →	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LPP →	Ligji i Prokurimi Publik
MASHTI →	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR →	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MSH →	Ministria e Shëndetësisë
OE →	Operatori Ekonomik
OSHP →	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKMF →	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
RrUOPP →	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
ShSKUK →	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
ZPRK →	Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës

Hyrje

Që nga fillimi i pandemisë në Kosovë në mars të vitit 2020, institucionet kanë filluar me blerjen e materialeve mbrojtëse, dezinfektimin e hapësirave në përpjekje për ta luftuar COVID-19. Për t'i blerë këto materiale, institucionet në masë të madhe kanë shfrytëzuar procedurën e negociuar të prokurimit publik, pra pa publikim të njoftimit për kontratë. Menjëherë pas paraqitjes së rasteve të para me COVID-19, Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP), kishte lëshuar njoftim për t'i lejuar autoritetet kontraktuese (AK) që t'i aplikojnë procedurat emergjente për blerje të materialeve që kanë të bëjnë me pandeminë. Përmes këtij njoftimi, operatorët ishin liruar edhe prej disa kërkesave tjera, siç janë vërtetimi i gjykatës, vërtetimi i ATK-së dhe sigurimi i tenderit. Ky vendim ka qenë në fuqi deri me 12 qershor 2020 kur edhe është shfuqizuar nga KRPP.

Pavarësisht shfuqizimit të këtij vendimi dhe duke pasur parasysh që pandemia COVID-19 nuk është më emergjencë, AK-të kanë vazhduar të lidhin kontrata të prokurimit me procedurë të negociuar. Duke pasur parasysh që çmimet e ofruara përmes kësaj procedure kanë dëshmuar që janë shumë më të larta, përdorimi i mëtutjeshëm i tyre është veprim që shkon në dëm të parasë publike.

Duke parë rëndësinë e përcjelljes së kësaj dukurie në prokurim publik, Demokraci Plus (D+) ka analizuar edhe dhjetë tenderë tjerë. Të gjeturat tregojnë që disa institucione kanë bërë hapa pozitiv në mënyrën e kontraktimit të furnizimeve dhe shërbimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga virusi. Megjithatë, procedurat e prokurimit vazhdojnë të kenë probleme të ndryshme, burimi i të cilave nuk gjendet vetëm në një hallkë. Disa tenderë kanë pasur probleme në përpilimin e specifikave, disa gjatë vlerësimit të ofertave, duke i anashkaluar shpesh mangësitë e ofertave, ku në disa raste janë kontraktuar ofertat e papërgjegjshme. Sigurisht, pjesë e gjetjeve është edhe ekzekutimi i kontratës, ku menaxhimi nuk është bërë siç duhet, me ç'rast janë dorëzuar produkte, të cilat nuk janë kontraktuar fare.

Disa nga kontratat janë lidhur me çmime shumë të larta, derisa ka pasur institucione që kanë lidhur kontrata me çmime jashtëzakonisht të ulëta. Nga ana tjetër, shumë AK kanë kërkuar dokumente që nuk përkojnë me natyrën e tenderëve të iniciuar, dhe si pasojë shumë OE nuk kanë ofertuar, duke çuar në dëmtimin e konkurrencës. Në anën tjetër, disa AK kanë paraqitur kërkesa minimale përmes procedurës tenderuese, dhe i është dhënë hapësirë shumë kompanive të paspecializuara të ofertojnë. Rreziku i kësaj është ofrimi i cilësisë së dobët dhe mosekzekutim i mirëfilltë i kontratës së dhënë. Në raport janë përfshirë edhe shkelje tjera që janë specifike për secilin tender.

Tenderi 1: Shërbime funerale COVID-19

Pas analizimit të tenderit për shërbime funerale, tender të cilin e kishte iniciuar Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) përmes procedurës emergjente në gusht të vitit 2020, D+ ka analizuar një tender tjetër të natyrës së njëjtë të lidhur nga ShSKUK. Ky aktivitet i prokurimit është bërë përmes procedurës së hapur.

Në një takim që D+ ka pasur me zyrtarët e prokurimit në ShSKUK[1], këta të fundit kanë theksuar që raporti i publikuar nga D+ në qershor 2021 për dhjetë (10) tenderët e vitit 2020[2], i ka shtyrë t'i bëjnë disa ndryshime gjatë inicimit të aktiviteteve pasuese të prokurimit. Sa për rikujtim, në paramasën e tenderit që është analizuar në raportin e parë (tender i vitit 2020), pozicionet kanë qenë të ndara veç e veç, si: përgatitja e trupave të vdekur nga COVID-19 dhe sëmundje të ngjashme; përgatitja e trupave të vdekur nga sëmundjet si ethet hemorragjike dhe të ngjashme; futja e tyre në arkivol metalik të mbyllur dhe të drurit; si dhe transporti i tyre nga vendndodhja e kufomës deri në destinacionin e caktuar në tërë Kosovën.

Tabela 1: Paramasa me çmimet e kontraktuara për tenderin "Shërbime funerale me COVID-19"

Artikulli	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSh	Çmimi total me TVSh
1.	Përgatitja e trupave të vdekur për varrim nga COVID-19 dhe sëmundje të ngjashme	rast	500	50.00€	25,000.00€
2.	Përgatitja e trupave të vdekur nga sëmundjet si ethet hemorragjike dhe të ngjashme	rast	500	50.00€	25,000.00€
3.	Arkivoli metalik i mbyllur hermetikisht	copë	500	150.00€	75,000.00€
4.	Arkivoli i drurit	copë	500	170.00€	85,000.00€
5.	Çmimi për kilometër për transportin e trupave të vdekur, (kufomës) nga vendi ku ndodhet kufoma apo spitali deri në destinacionin e caktuar në tërë Kosovën.	km	1	1.00€	1.00€
	TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH:				**210,001.00 €**

Kjo kontratë ishte lidhur për 12 muaj si kontratë kornizë, por ishte shkelur tavani i vlerës inidikative prej +30%, gjë të cilën e ndalon Ligji i Prokurimit Publik (LPP). Në këtë rast, ShSKUK ka pasur të drejtë të bëjë porosi vetëm

1 Takim me Selami Krasniqin dhe Besnik Cenaj, 01.10.2021.
2 COVID-19 si pretekst për lidhje të kontratave emergjente në prokurim publik (raporti I), qershor 2021: https://bit.ly/3CltuP7

deri në vlerën prej 273,001.30 euro, por shuma e cila ishte shpenzuar kishte shkuar në 399,116.60 euro. Pra, me këtë tejkalim, ShSKUK ka shpenzuar 126,115.30 euro më shumë sesa që i është lejuar me rregullin +30%.

Pas këtij tenderi, ky institucion kishte hapur edhe disa tenderë tjerë të së njëjtës natyrë, ku çdo herë e më shumë kishin rënë çmimet, me ç'rast këto ulje janë vërejtur edhe në kontratën e fundit, ku çmimi i kontraktuar është përgjysmë më i lirë se herën e parë. Kësaj radhe, ShSKUK në paramasë ka listuar të gjitha pozicionet në një të vetme. Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar nëntë operatorë ekonomik, konkurrencë kjo dukshëm më e lartë sesa në kontratën e parë, e cila ishte zhvilluar përmes procedurës së negociuar. Në mesin e këtyre nëntë OE-ve, si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët është shpallur kompania Funerali Sh.P.K., me çmim për njësi prej 158 eurosh, e atë për të gjitha shërbimet e listuara në tabelën më poshtë.

Tabela 2 - Paramasa me çmimet e kontraktuara për tenderin "Shërbime funerale për COVID-19" - 00220-21-5733-2-1-1

Artikulli	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSh	Çmimi total me TVSh
1.	Përgatitja e trupave të vdekur për varrim, nga Covid -19, ethet hemorragjike dhe të ngjashme. Transporti i tyre nga vendi ku ndodhet kufoma apo spitali deri në vendin e varrimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.	rast	1,000	158.00€	158,000.00€
	TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH:				**158,000.00 €**

Tabela 2 tregon që gjetjet e publikuara nga monitorimi i tenderit të parë që kishte lidhur ShSKUK për këto shërbime, kanë dhënë rezultat përmes uljes së çmimeve. Tani ShSKUK paguan për të gjitha shërbimet vetëm 158 euro (për një rast), çmim ky i përafërt me atë që paguante vetëm për një arkivol të drurit sipas kontratës së parë të nënshkruar me OE 'Ngushëllimi'.

Për tenderin e dytë, ShSKUK nuk ka kërkuar asnjë kërkesë të mundësive teknike dhe profesionale dhe as dëshmi për qarkullim financiar[3], pavarësisht që tenderi është i vlerës së madhe, sidoqoftë kjo është në diskrecion të AK-së. Për këtë tender janë kërkuar vetëm kërkesa të përshtatshmërisë: deklarata nën betim, vërtetimi tatimor dhe vërtetimi i gjykatës, si dhe kërkesat e përshtatshmërisë profesionale: certifikata e regjistrimit të biznesit, certifikata e TVSh-së dhe certifikata e numrit fiskal. OE fitues 'Funerali' nuk e ka dorëzuar certifikatën e numrit fiskal, dokument të cilin AK është dashur ta kërkojë përmes sqarimeve shtesë.

3 Qëllimi i këtij kriteri është qe të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitetin e të mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar: https://bit.ly/3os7mgQ

Te specifikimi teknik i detyrueshëm që gjendet në Dosjen e Tenderit (DT), është kërkuar edhe dezinfektimi i arkivolit, makinës dhe hapësirës, por nga ana tjetër nuk është kërkuar leje e veçantë për dezinfektim, dezinsektim dhe deratizim, leje kjo që duhet të lëshohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Meqenëse një gjë e tillë nuk është kërkuar nga AK, ky shërbim mund të mos kryhet siç duhet apo mund edhe të dështojë.

Tenderi 2: Furnizim me pajisje personale mbrojtëse kundër COVID-19

Ministria e Shëndetësisë (MSh), si njëra prej institucioneve kyçe në luftën ndaj pandemisë, ka iniciuar në vazhdimësi tenderë për ta mbrojtur shëndetin publik. Një tender që MSh ka iniciuar së fundi ka të bëjë me blerjen e pajisjeve personale mbrojtëse kundër COVID-19, i ndarë në 14 llote me vlerë totale të parashikuar prej 2,414,423.00 euro. Për shkak se disa llote përmbajnë artikuj të rëndësishëm për mbrojtje nga COVID-19, për t'u analizuar janë përzgjedhur llotet 1,2,9 dhe 14. Vlera e parashikuar për llot 1 ka qenë 14,040.00 euro, për llot 2 ka qenë 713,250.00 euro, për llot 9 ka qenë 241,554.00 euro dhe për llot 14 ka qenë 9,984.00 euro.

Për llotin 1 është kërkuar furnizimi me maska faciale njëpërdorimshe në një kohëzgjatje prej 12 muajve, me sasi prej 234,000.00 copë. Për llotin 2 që ka të bëjë me maska respiratore ffp2, brenda 12 muajve pritet të porositen 317,000.00 copë. Për llot 9 është kërkuar furnizim me dezinfektues një litërsh së bashku me dispenzer, ku për 12 muaj planifikohen të porositen 76,200.00 litra në tërësi, ndërkaq për llot 14 është planifikuar që brenda kësaj periudhe të porositen 2,400.00 qese për kufoma.

Për llotin 1 kishin ofertuar tetë Operator Ekonomik (OE), me çmime të ndryshme, ndërsa me kontratë është shpërblyer Grupi i Operatorëve Ekonomik (GOE) Exclusive Corporation Sh.P.K. & Pharma Leader L.L.C., në vlerë prej 4,680.00 euro.

Figura 1 – Tabela me operatorët ekonomikë që ofertuan në Lot 1 dhe vlera e ofertave të tyre

LOT 1	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
112	Grup i Operatorëve Ekonomik EXCLUSIVE CORPORATION SH.P.K.; PHARMA LEADER L.L.C., Hilmi Rakovica Nr 43, 10000, Prishtine	4,680.00
34	Ardi SH.P.K., 187,Nënë Tereza,Fushë Kosovë, 12000, Fushë Kosovë	7,020.00
44	N.T.SH. Koslabor, Lagja e re, 23000, SUHAREKË	7,020.00
50	" Agani L.t.d " Sh.p.k., Magj. Prishtine-Ferizaj, Km.5 Graçanice, 10000, PRISHTINE	7,020.00
62	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	7,020.00
99	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	9,126.00
3	MATKOS PHARM SH.P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË	11,700.00
27	REDONI HM SH.P.K., Rr. Behar Begolli p.n, 10000, Prishtinë	11,700.00

Për llotin 2 kishin ofertuar nëntë OE, ku me kontratë është shpërblyer po i njëjti OE sikurse në llot 1. OE i shpërblyer me llotin e dytë, GOE Exclusive Corporation Sh.P.K. & Pharma Leader L.L.C., ka ofertuar me 31,700.00 euro, me ç'rast edhe ishte oferta më e lirë.

Figura 2 – Tabela me operatorët ekonomikë që ofertuan në Lot 2 dhe vlera e ofertave të tyre

LOT 2	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
113	Grup i Operatorëve Ekonomik EXCLUSIVE CORPORATION SH.P.K.; PHARMA LEADER L.L.C., Hilmi Rakovica Nr 43, 10000, Prishtine	31,700.00
63	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	53,890.00
100	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	85,590.00
51	" Agani L.t.d " Sh.p.k., Magj. Prishtine-Ferizaj, Km.5 Graçanice, 10000, PRISHTINE	91,930.00
4	MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË	155,330.00
35	Ardi SH.P.K., 187,Nënë Tereza,Fushë Kosovë, 12000, Fushë Kosovë	187,030.00
80	" Liri - Med " SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, -10000, PRISHTINË	216,954.80
89	Medical Group SH.P.K., Fehmi Agani 69 /B 10, -, PRISHTINË	475,500.00
17	" LEGO " SH.P.K., Veternik, 10000, Prishtina	490,018.60

Për llotin 9 kishin ofertuar dymbëdhjetë OE, ku prap fitues ishte GOE Exclusive Corporation Sh.P.K. & Pharma Leader L.L.C., oferta e të cilëve ka vlerën prej 114,300.00 euro.

Figura 3 – Tabela me operatorët ekonomikë që ofertuan në Lot 9 dhe vlera e ofertave të tyre

LOT 9	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
60	PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj	168,402.00
119	Grup i Operatorëve Ekonomik EXCLUSIVE CORPORATION SH.P.K.; PHARMA LEADER L.L.C., Hilmi Rakovica Nr 43, 10000, Prishtine	114,300.00
24	" LEGO " SH.P.K., Veternik, 10000, Prishtina	124,084.08
57	" Agani L.t.d " Sh.p.k., Magj. Prishtine-Ferizaj, Km.5 Graçanice, 10000, PRISHTINE	138,684.00
11	MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË	148,590.00
70	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	148,590.00
46	N.T.SH. Koslabor, Lagja e re, 23000, SUHAREKË	175,260.00
42	Ardi SH.P.K., 187,Nënë Tereza,Fushë Kosovë, 12000, Fushë Kosovë	179,832.00
107	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	190,500.00
83	" Liri - Med " SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, -10000, PRISHTINË	224,790.00
91	Medical Group SH.P.K., Fehmi Agani 69 /B 10, -, PRISHTINË	240,792.00
95	N.T.P "ERAMED", Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	403,860.00

Ndërsa, për llotin 14 dhe të fundit të këtij tenderi, OE që është shpërblyer me kontratë është Madekos Sh.P.K., oferta e të cilit ishte 12,000.00 euro.

Figura 4 – Tabela me operatorët ekonomikë që ofertuan në Lot 14 dhe vlera e ofertave të tyre

LOT 14	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
123	Grup i Operatorëve Ekonomik EXCLUSIVE CORPORATION SH.P.K.; PHARMA LEADER L.L.C., Hilmi Rakovica Nr 43, 10000, Prishtine	1.00
75	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	12,000.00
33	REDONI HM SH.P.K., Rr. Behar Begollli p.n, 10000, Prishtinë	12,552.00
16	MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË	14,400.00

Në llotet 1,2 dhe 9 vërehet një diskrepancë e madhe mes vlerës së parashikuar dhe vlerës së ofertës. Vlera e parashikuar për llotin 1 ishte 14,040.00 euro ndërsa OE i shpërblyer me kontratë ka ofertën në vlerë prej 4,680.00 euro, apo 9,360 euro më pak. Për llotin 2, vlera e parashikuar ishte 713,250.00 euro, ndërsa oferta e OE fitues ishte 31,700.00 euro, apo 681,550.00 euro më pak. Ndërkaq te lloti 9, dallimi ndërmjet vlerës së parashikuar dhe çmimit të kontratës është 127,254.00 euro, pasi vlera e parashikuar për këtë llot është 241,554.00 euro e vlera e kontratës 114,300.00 euro. Në këto raste, dyshimet e para janë çmimet jonormalisht të ulëta ose mungesa e hulumtimit të tregut, hulumtim të cilin duhet ta bëjë vetë AK-ja.

Me datë 27.09.2021, OE Agani LTD ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, e atë për llotet 1,2 dhe 5. AK e ka refuzuar kërkesën për dy llotet e para (1 dhe 2) me arsyetimin se si kërkesë është bërë pas afatit, ndërsa për llotin 5, e ka refuzuar si të pabazuar. Për të njëjtat llote, ky OE ka parashtruar edhe ankesë kundër njoftimit për dhënie në OShP. Mirëpo, për shkak që ende nuk janë përzgjedhur anëtarët e bordit të OShP-së, sekretari i përgjithshëm i OShP-së ka marrë vendim që llotet 1 dhe 2 të hudhen si të palejuara për shkak të kalimit të afateve kohore për parashtrim të ankesës, ndërkaq ankesa për llotin 5 është ende në proces. AK ka vazhduar me lidhjen e kontratës me GOE Exclusive Corporation & Pharma Leader, si për llotin 1, ashtu edhe për llotin 2.

Çmimet e maskave njëpërdorimshe (lloti 1) janë shumë të lira ku një maskë sipas kësaj kontrate do të blihet me vetëm 0.02 euro. Nga shumica e kontratave të analizuara nga D+, ky tender ka arritur që të blejë maskat me çmimin më të ulët, pasi çmimi mesatar në treg sillet rreth 0.04 dhe 0.05 euro.

Figura 5 - Përshkrimi i çmimeve për llot 1

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr. LOT	Emertimi i produkteve	Njësia	Sasia e planifikuar per 12 muaj	Çmimi për njësi pa tvsh €	TVSH (%)	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €	Prodhuesi dhe vendi i origjines	Afati i liferimit max. 30 ditë
1	Facial mask for a single use (Maskë faciale për një perdorim)	Copë	234,000	0.0169Eur	0.0030	0.02 Eur	4,680.00 Eur	Pharmax Medical Turqi	30 dite
						Totali (DDP):	4,680.00 Eur		

E njëjta situatë është edhe me llotin 2, ku maskat me respirator ffp2 janë blerë me 0.10 euro për copë. Një maskë e tillë në treg ka çmimin mesatar 0.60 euro. Nëse marrim parasysh vlerën e parashikuar të kontratës, çmimet e OE-ve të tjera, çmimet e tregut dhe koston e importimit, vihet në pikëpyetje nëse do të ekzekutohet siç duhet kontrata, por edhe se çfarë cilësise do të jenë maskat që do të dorëzohen në ministri.

Figura 6 - Përshkrimi i çmimeve për llot 2

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr. LOT	Emertimi i produkteve	Njësia	Sasia e planifikuar per 12 muaj	Çmimi për njësi pa tvsh €	TVSH (%)	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €	Prodhuesi dhe vendi i origjines	Afati i liferimit max. 30 ditë
2	FFP2 respiratory masks, with valve, extra light, latex and PVC free (Respiratorë FFP)	Copë	317,000	0,084 Eur	0.0150	0.10 Eur	31,700.00 Eur	LDR TURQI	30 Dite
						Totali (DDP):	31,700.00 Eur		

Njësoj si me llotet 1 dhe 2, edhe për llot 9 është parashtruar kërkesa për rishqyrtim nga OE Lego Sh.P.K. I njëjti ka parashtruar ankesë për llot 2,3,4,5,8,9 dhe 13, mirëpo, kërkesa është pranuar pjesërisht vetëm për llot 13, ndërsa AK ka proceduar tutje me llotet e tjera. OE ankues, nuk ka përcjellur ankesën në OShP, prandaj edhe AK ka vazhduar me lidhjen e kësaj kontrate.

Nga figura 7, e paraqitur më poshtë, shohim se një litër dezinfektues është blerë me vetëm 1.50 euro, çmim i cili është jashtëzakonisht i ulët në krahasim me çmimet aktuale. P.Sh. Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në fund të muajit gusht të vitit 2021, ka blerë një dezinfektues gel 500ml me 1.60 euro, ndërsa atë në formë spreji me 2.00 euro, pra vetëm për gjysmën e sasisë ka paguar më shumë sesa MSh-ja për dezinfektuesin një litërsh. Përveç kësaj, në rastet kur porositet një dezinfektues me dispenzer, ka kosto shtesë.

Figura 7 - Përshkrimi i çmimeve për llot 9

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr. LOT	Emertimi i produkteve	Njësia	Sasia e planifikuar per 12 muaj	Çmimi për njësi pa tvsh €	TVSH (%)	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €	Prodhuesi dhe vendi i origjines	Afati i liferimit max. 30 ditë
9	Hand disinfection substance with stand alone dispenser, active against viruses, mycobacteria and other microorganisms, non-hazardous to people and environment (Dezinfektues për duar së bashku me dispenzer)	litër	76,200	1.27 Eur	0.23 Eur	1.50 Eur	114,300.00 Eur	Naturel Medical Ilac Sanayi TURQI	30 dite
						Totali (DDP):	114,300.00 Eur		

Në bazë të nenit 61 të Ligjit të prokurimit publik (LPP), nëse një OE dorëzon një ofertë që me çmim shumë të ulët, AK duhet të dërgojë kërkesë me shkrim te OE për sqarime. Në bazë të sqarimeve të dhëna, AK mund të vendosë ta nënshkruajë apo jo kontratën. Pra, nëse AK konstaton se kemi të bëjmë me tender me çmime shumë (jonormalisht) të ulëta, gjë që do vështirësojë edhe implementimin e kontratës, oferta e të njëjtit mund të refuzohet.

Figura 8 - Përshkrimi i çmimeve për llot 14



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr. LOT	Emertimi i produkteve	Njësia	Sasia e planifikuar per 12 muaj	Çmimi për njësi pa tvsh €	TVSH (%)	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €	Prodhuesi dhe vendi i origjines	Afati i liferimit max. 30 ditë
14	Body bags (Qese për kufoma)	Copë	2,400	€ 4.2373	18%	€ 5.00	€ 12,000.00	BYM MEDIKAL TURQI	30 DITE
						Totali (DDP):	€ 12,000.00		

Për llotin 14 është tejkaluar vlera e parashikuar për rreth 2 mijë euro. Në këtë drejtim, AK nuk ka bërë planifikim të mirëfilltë të këtij aktiviteti të prokurimit. Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RrUOPP), parallogaritja e shpenzimeve duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.

Si kërkesë ka qenë edhe dorëzimi i ISOS 13485 dhe certifikatës CE. Data e skadencës për këto dy dokumente është 20.05.2021, duke pasur parasysh se data e fundit për ofertim ka qenë 31.08.2021, atëherë rezulton që dorëzimi i tyre me afat të skaduar e ka bërë ofertën të papërgjegjshme.

Tenderi 3: Blerja e dezinfektuesve për nevojat e shkollave të Kosovës

Me qëllim të furnizimit të shkollave me dezinfektuesë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në fillim të vitit 2021 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit "Blerja e dezinfektuesve për nevojat e shkollave të Kosovës". Ky tender është zhvilluar me procedurë të hapur, ku më 19 shtator 2021 është lidhur kontrata ndërmjet MASHTI-it dhe grupit të operatorëve ekonomikë Teknika Sh.P.K. dhe Ndërmarrjes Tregtare Librare "Rilindja" (tutje Rilindja). Kjo kontratë është e llojit kornizë dhe çmimet me të cilat kanë ofertuar OE-të kanë qenë çmime të peshuara.

Konsorciumi Teknika & Rilindja kanë ofertuar me çmimin për njësi 1.41 euro, ndërsa shuma totale e ofertës është planifikuar të jetë 490,000.00 euro, aq edhe sa ka qenë edhe vlera e parashikuar për këtë tender. Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë katër OE, ku dy prej tyre kanë pasur çmime më të ulëta për njësi. Mirëpo, sipas Raportit të Vlerësimit[4] që ka nxjerrë MASHTI, dy OE që kanë qenë më të lira se GOE fitues janë eliminuar, ngase nuk i kanë përmbushur të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë të listuara në DT.

4 Raporti i Vlerësimit është pjesë e ofertës që e ka siguruar D+.

Tabela 3 - OE-të që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit

Operatori ekonomik	Oferta me çmim të peshuar
GOE Teknika Sh.P.K. & Ndërmarrja Tregtare Librare "Rilindja"	1.41 euro
GOE Nita Macula B.I. & Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.	1.49 euro
GOE Ardi Sh.P.K. & Infinit Sh.P.K.	0.45 euro
Pro Medical Sh.P.K. & Pharma Group	0.57 euro

Në paramasë janë paraqitur katër pozicione, tre prej tyre me dezinfektuesë, ndërsa një me maska. Pozicioni i parë - Sanitues dore pa alkool 50 ml është peshuar me 10%, pozicioni i dytë -Sanitues dore pa alkool 100 ml është peshuar me 30%, pozicioni i tretë - Dezinfektuesë 500 ml, me 70 % alkool është peshuar me 20%, dhe pozicioni i katërt - Maska kirurgjikale trishtresore njëpërdorimshe është peshuar me 40%. Çmimi i pozicionit të parë para peshimit ka qenë 1.14 euro, ndërsa pas peshimit, çmimi për njësi për këtë artikull është bërë 0.11 euro.

Artikulli i dytë, para peshimit ka pasur çmimin 1.73, ndërsa pas peshimit - 0.52 euro. Pozicioni i tretë para peshimit ka pasur çmimin 3.63 euro, ndërsa pas peshimit, çmimi i këtij artikulli ka qenë 0.73 euro. Pozicioni i fundit, i cili është peshuar me 40%, para peshimit ka pasur çmimin 0.12 euro, ndërsa pas peshimit - 0.05 euro. Sipas kësaj forme të kontraktimit, peshimi i tillë i çmimeve bëhet vetëm për të vlerësuar ofertën, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi. P.Sh., te artikulli i parë, AK do të porosisë atë artikull deri në 10% të vlerës totale të kontratës me çmim prej 1.14 euro.

Tabela 4 - Çmimet për njësi para dhe pas peshimit të tyre

Renditja	Artikulli	Çmimi për njësi para peshimit (me TVSH)	Peshimi i çmimit	Çmimi për njësi (me TVSH) pas peshimit
A	Artikulli 1	1.14	10%	0.11
B	Artikulli 2	1.73	30%	0.52
C	Artikulli 3	3.63	20%	0.73
D	Artikulli 4	0.12	40%	0.05
		6.62	100%	1.41

Duke u bazuar në Dosjen e Tenderit dhe kërkesave që AK ka paraqitur në të, vërejmë së në disa pozicione GOE Teknika & Rilindja, nuk i ka plotësuar si kërkesa.

Në Dosjen e Tenderit, AK ka paraqitur shumë kërkesa, duke filluar nga certifikatat e deri te stafi i domosdoshëm për t'i kryer punët e parapara në këtë tender. Në Dosjen e Tenderit, AK ka kërkuar që të punësohet një farmacist, kërkesë e cila është e panevojshme për furnizime të tilla, me ç'rast dëmtohet edhe konkurrenca. Në anën tjetër, AK ka kërkuar nga GOE që kualitetin dhe përputhshmërinë e këtyre artikujve ta vërtetojë përmes certifikatave ISO, pra të ofrojë dëshmi se artikujt janë në përputhshmëri me standardet evropiane, po ashtu janë kërkuar autorizime e licenca. Në rastet kur OE arrin që ta dëshmojë përmes gjithë këtyre dokumenteve se artikujt e ofruar janë në përputhje me kërkesat e AK-së, atëherë roli i farmacistit në këtë rast është i panevojshëm.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar po ashtu që të ofrohet një listë e kontratave të ngjashme të cilat tashmë janë ekzekutuar nga OE, të njëjtat duhet të dëshmohen me referenca dhe të arrijnë vlerën jo më pak se 250,000.00 euro. GOE ka ofruar listën me kontrata të tilla, mirëpo ka dorëzuar vetëm dy referenca. Njëra referencë ka vlerën prej 9,456.67 euro, ndërkaq tjetra referencë kap vlerën 72,228.65 euro. Për kontratat e tjera që ky konsorcium ka listuar, janë dorëzuar fatura, të cilat nuk dëshmojnë ekzekutimin e kontratave. Ky është elementi i dytë që e bënë këtë GOE të papërgjegjshëm për këtë tender.

Për të dëshmuar përshtatshmërinë e artikujve të kërkuar në listën e çmimeve, AK ka kërkuar që OE-të të paraqesin broshura apo katalogun për të gjithë artikujt, ku duhet të përshkruhet produkti dhe specifikat teknike të tyre. Në mesin e disa dokumenteve në gjuhë të huaj, broshura e dërguar për maskë, artikulli 4, është dorëzuar në gjuhën holandeze. Kjo broshurë nuk do të duhej të pranohej nga AK, pasi një gjë e tillë është paraparë në nenin 13 të LPP-së[5]. Ky nen specifikon që OE mund të paraqesë një dokument vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Përveç këtyre të gjeturave, as artikujt nuk i plotësojnë kërkesat e DT-së. Në pozicionet 1 dhe 2 të paramasës kërkohet që sanituesi 50ml dhe 100ml të jenë në formë spreji, ndërsa te broshurat e ofruara shohim se asnjëri nga sanituesit e kërkuar nuk janë në formë spreji. Edhe sikur AK të ketë pranuar dezinfektuesë në formë spreji, një broshurë e tillë nuk është dashur të pranohet, pasi nuk dëshmon që këta dy artikuj i përmbushin specifikat e kërkuar.

Figura 9 - Broshura e artikullit 1 dhe 2

5 Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 13: https://bit.ly/3cket5s

Ky aktivitet është iniciuar me qëllim që të pajisen shkollat me dezinfektuesë dhe maska. Mirëpo, që nga lidhja e kontratës, në gusht të vitit 2021, Zyra e Financave e MASHTI-t nuk ka asnjë faturë[6] që dëshmon për blerjen e tyre, edhe viti shkollor ka filluar në fund të muajit shtator 2021. Mungesa e faturave dhe pagesave dëshmon që nuk është bërë akoma asnjë furnizim dhe si rezultat shkollat nuk janë pajisur as me dezinfektuesë dhe as me maska.

Për më tepër, këto dy kompani që kanë formuar konsorciumin nuk janë të specializuara në veprimtari të tilla. Si aktivitete primare këto dy kompani kanë tregtinë me pakicë të gazetave dhe materialeve të shkrimit e aktivitete të tjera prodhuese.

Tenderi 4: Blerja e maskave mbrojtëse për nxënësit në kushte pandemie

Aktiviteti i prokurimit "Blerja e maskave mbrojtëse për nxënësit e Republikës së Kosovës në kushte pandemie" është iniciuar ng MASHTI përmes procedurës së negociuar, pak para fillimit të vitit shkollor në vitin 2020. Konkretisht, MASHTI më datë 11 shtator 2020 ka marrë vendim që më datë 14 shtator 2020 të fillojë viti i ri shkollor. Në po të njëjtën ditë (14 shtator), Departamenti i Arsimit Parauniversitar, ka paraqitur kërkesën që me urgjencë të fillojë procedura e prokurimit për furnizim me maska për nxënësit e Republikës së Kosovës.

Për këtë aktivitet të prokurimit, vlera e parashikuar është 70,000.00 euro, ku me kontratë është shpërblyer Yoobopo Sh.P.K., nënshkruar më 22 shtator 2020. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të negociuar dhe AK ka ftuar disa OE për t'i dorëzuar ofertat e tyre. Sipas procesverbalit të hapjes, shohim se OE i vetëm i cili ka dërguar ofertë është Yoobopo Sh.P.K, i cili pastaj më 17 shtator 2020 është ftuar në negociata me ministrinë. OE Yoobopo ka ofertuar me 0.15 euro për një maskë dhe i njëjti nuk ka pranuar që ta ulë çmimin në këto negociata, pasi sipas tij çmimi i ofertuar është i ulët në krahasim me çmimin aktual të tregut.

Tabela 5 - OE e ftuar në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Operatorët Ekonomikë të ftuar të marrin pjesë në procedurë
1.	Blendi
2.	Teknika Sh.P.K.
3.	Yoobopo Sh.P.K.

AK në këtë rast është dashur të ftojë kompani të specializuara në këtë fushë, siç është OE fitues, por jo të ftojë kompani si Blendi dhe Teknika, të cilat nuk e kanë si aktivitet primar tregtinë me produkte medicinale.

AK ka lidhur këtë kontratë kornizë me OE Yoobopo Sh.P.K. me çmimin prej 0.15 euro për njësi. Praktikat e lidhjes së kontratave kornizë për produkte që çdo ditë i bie çmimi, është veprim jo i duhur që AK-të në përgjithësi e kanë aplikuar. Maskat si produkt, që nga paraqitja e virusit, kanë qenë produkti më i kërkuar në treg për çka ka pasur edhe rritje të madhe të çmimit. Mirëpo, në pjesën e dytë të vitit 2020 e tutje, çmimet për maskat kanë

6 Konsultim i D+ me MASHTI sipas kërkesës për qasje në dokumente publike, datë: 19.10.2021.

pësuar ulje çdo herë e më shumë. Sa për ta demonstruar, në periudhën kur është lidhur kontrata, ka pasur AK që kanë blerë maska me çmime edhe më të ulëta. P.Sh. Komuna e Fushë Kosovës më 26 gusht 2020 ka lidhur kontratë me Sh.P.K. Agani për të blerë maska medicinale më 0.10 euro. Një tjetër rast është Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), ku në muajin nëntor të vitit 2020 ka lidhur kontratë me Matkos Pharm, ku çmimi i një maske është përcaktuar me vetëm 0.06 euro.

Vlera e cila lejohet të shpenzohet për këtë kontratë është 70,000.00 euro, por, për shkak se kemi të bëjmë me kontratë publike kornizë, kjo vlerë mund të ndryshojë në +/- 30% të vlerës indikative të kontratës. Në rast të arritjes së pragut të lejuar, AK nuk mund të bëjë porosi të tjera. Kjo nuk do të thotë që AK të paguajë për furnizimet e paporositura, por duhet që të porosisë së paku deri në 70% të vlerës indikative të vendosur. Fatura e parë dhe e vetmja deri në momentin e ofrimit të qasjes në këtë tender, është realizuar më 24 shtator 2020, dy ditë pas lidhjes së kontratës. Vlera e kësaj fature është 60,225.64 euro, që nënkupton se pjesa më e madhe e kontratës është realizuar dhe më shumë se gjysma e buxhetit është shpenzuar.

Tenderi 5: Furnizim me pajisje mbrojtëse kundër COVID-19

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK) në gusht të vitit 2020 ka hapur tender për të blerë maska njëpërdorimshe, dezinfektuesë dhe për të marrë shërbime dezinfektimi. Ky tender është ndarë në dy llote, me vlerë të parashikuar prej 30,500.00 euro. Llotin e parë, për maska njëpërdorimshe dhe dezinfektuesë, e kishte fituar Matkos Pharm Sh.P.K, në vlerën totale të kontratës prej 22,000 euro. Kontrata është e llojit kornizë dhe përfundon më 30 shtator 2023, me ç'rast dhe porositë mund të bëhen deri në këtë datë varësisht nga nevoja e këtij institucioni.

Një prej problemeve në Dosje të Tenderit ka qenë mosspecifikimi i sasisë së kërkuar të dezinfektuesit, ku kompanitë kanë ofertuar me sasi të ndryshme. Kjo gjë, sipas edhe takimit[7] që është mbajtur me përfaqësuesë të Zyrës së Prokurimit të këtij institucioni, ka paraqitur problem edhe në vlerësimin e ofertave. Fituesi i kontratës, OE Matkos Pharm ka ofertuar me dezinfektuesin 100 ml, mirëpo gjatë furnizimit kishte sjellur dezinfektuesin 500 ml.

Pra, në njërën prej faturave të paguara nga ZPRK, është paguar edhe një produkt që nuk është paparaparë me kontratë. Në vend të dezinfektuesve 100 ml me të cilët kishte ofertuar çmimin 0.80 €, në faturë figuron dezinfektuesi në sasi prej 500 ml, me çmim prej 4 €.

Figura 10 - Fatura me produktin e pakontraktuar – dezinfektuesin antiseptik 500 ml

Whs. No./ : 100 / DEPO

Kodi	Pershkrimi	Sasia	Njsia	Çmimi per njesi	TVSh	Çmimi me TVSH	Vlera
SP.MAT.0001	MASKA MBROJTESE KIRURGJIKE NJE PERDORIMSHE	150	KUTI	6.7	18	7.91	1186.5
SP.SHQ.0029.U	DEZINFEKTUES ANTISEPTIC 500ML	30	COPE	3.389	18	4	120

Baza e TVSH-së 18 1,107.20

P. K.

7 Takimi me përfaqësuesë të ZPRK, më datë 17.11.2021.

Kjo shkelje e kontratës ndikon drejtpërdrejt edhe në dëmtimin e buxhetit të shtetit, pasi çmimi prej 4.00 euro për një dezinfektues 500 ml është dyfish më i lartë sesa çmimet që janë kontraktuar nga autoritetet tjera kontraktuese. Për një dezinfektues të tillë të së njëjtës sasi, çmimi mesatar me të cilin është blerë nga AK-të tjera, në të njëjtën periudhë kohore, është rreth 2.00 €.

Në ditën e takimit me ZPRK-në, D+ është njoftuar se ky institucion dhe kompania fituese kishin lidhur marrëveshje[8] për ta ndërprerë furnizimin me dezinfektuesin e kontraktuar, gjë që nuk është e lejuar.

Nga ana tjetër, duhet cekur që lidhja e kontratave kornizë për një periudhë kaq të gjatë është veprim me rrezik, pasi çmimet për këto produkte vazhdimisht janë ulur që nga fillimi i pandemisë. Duke pasur parasysh këtë ulje të vazhdueshme të çmimeve, lidhja e kontratave kornizë gjithmonë shkon në dëm të parasë publike, pasi është obligim t'u përmbahen çmimeve të kontraktuara.

Në këtë drejtim, çmimet me të cilat ka ofertuar kjo kompani janë shumë më të larta sesa që gjenden në treg. Shumë institucione maskën njëpërdorimshe e blejnë për rreth 0.04 euro, derisa ZPRK-ja në e ka blerë një të tillë për 0.15 euro, që i bie gati katër herë më shtrenjtë se çmimi i tregut.

Nga analizimi i DT-së, vërehet që Matkos Pharm Sh.P.K. nuk e ka plotësuar një prej kërkesave të AK-së që është cekur te specifikacioni teknik. Zyra e Presidentit kishte kërkuar që dezinfektuesit të jenë të listuar te dezinfektuesit antivirusal nga IHO[9] dhe të jenë të certifikuar nga VAH[10]. Sipas Ligjit të prokurimit publik, "autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian, (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim"[11]. Sipas kësaj dispozite, AK nuk mund të kërkojë standarde të tilla që i përkasin vetëm një shteti, siç është Gjermania. Mirëpo, edhe pse ishte bërë si kërkesë, Matkos Pharm nuk ka ofruar asnjë dëshmi që e përmbushë këtë kusht, gjë që oferta e tij është dashur të refuzohet. Me fjalë të tjera, mospërmbushja e kësaj kërkese nuk e ka penalizuar, përkundrazi i njëjti operator është shpërblyer me kontratë.

Në Dosjen e Tenderit po ashtu ishte kërkuar që dezinfektuesi të përmbajë se paku 75 gr propan, dexpanthenol, ethylexlglycerin, dhe panthenol, mirëpo dezinfektuesi me të cilin ka ofertuar fituesi ka përbërës të tjerë sipas dokumentacionit për të dhënat e sigurisë. Sipas dokumenteve të dorëzuara në ofertë, dezinfektuesi i prodhuesit me të cilin ka ofertuar Matkos Pharm ka këta përbërës: alkool etilik i çnatyruar 70%, karbomer, glicerinë, vitamin E, aloe vera xhel, trietanolaminë, aromë dhe ujë të çjonizuar. Sipas kësaj, as Matkos Pharm nuk i ka plotësuar kërkesat e DT, me ç'rast është dashur të eliminohet.

Lloti i dytë i këtij aktiviteti të prokurimit ka shkuar dy herë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OShP). Fillimisht, për këtë llot është shpallur fitues Samire Osmani B.I., për të cilin vendim OE 'Crazy pet' ishte ankuar në OShP, me pretendimet që e njëjta nuk i plotëson specifikat teknike sipas DT-së. Paneli shqyrtues i OShP-së kishte vendosur në favor të ankuesit duke e kthyer lëndën në rivlerësim. Pas rivlerësimit, AK ka shpallur fitues 'Crazy pet' me 0.39 euro për metër katror, me ç'rast vlera e kontratës është 8,000 euro . Çmimi prej 0.39 euro për metër katror konsiderohet si çmim mjaft i lartë krahasuar me çmimet e tregut. Çmimet për shërbime të dezinfektimit sipas ekspertëve të Dezinfektimit, Dezinsketimit dhe Deratizimit (DDD) variojnë nga 0.17 euro deri më 0.20 euro.

8 Marrëveshje me shkrim ndërmjet ZPRK-së dhe OE Matkos Pharm Sh.P.K e lidhur më datë 11.11.2020.
9 IHO është Shoqatë Industriale Gjermane për Higjienën dhe Mbrojtjen e Sipërfaqes.
10 Nga shkurtesa në gjermanisht që ka kuptimin e Shoqatës mbi Cilësinë e Higjienës në Gjermani.
11 Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 28, paragrafi 4.

Tenderi 6: Furnizim me material për mbrojtje nga COVID-19 në zgjedhjet lokale

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka ritenderuar[12] aktivitetin e prokurimit për furnizim me material për mbrojtje nga COVID-19 për zgjedhjet lokale të mbajtura në tetor 2021. Tenderi është zhvilluar përmes procedurës së negocimit, si procedurë emergjente. Në këtë ritenderim, AK ka ftuar tre OE-të, të cilët kanë ofertuar edhe herën e parë, GOE IRIS PHARM Sh.P.K. & Ardi Sh.P.K., ECO SOLUTION Sh.P.K. dhe GOE Blendi O.P. & PHARMA GROUP Sh.P.K. Në mesin e tre ofertuesve, si i përgjegjshëm është shpallur konsorciumi GOE IRIS PHARM Sh.P.K. & Ardi Sh.P.K, i cili në fakt ka çmimin më të lartë prej 86,555.20 euro.

Për një maskë njëpërdorimshe, ky OE ka ofertuar me 0.10 euro, ndërsa një palë doreza janë blerë përmes kësaj kontrate me 0.15 euro. Të njëjtat produkte, tani mund të gjenden me një çmim shumë më të lirë në treg, për shkak të uljes së vazhdueshme të çmimeve.

Në një nga kërkesat e Dosjes së Tenderit, AK ka kërkuar certifikatën ISO 13485:2016 për maskat, gjë që fituesi nuk e ka dorëzuar. Në ofertën e IRIS PHARM Sh.P.K. & Ardi Sh.P.K ekziston kjo ISO, por vetëm për doreza, jo për maska ashtu siç kërkohet.

Përveç kësaj, konsorciumi fitues nuk e ka plotësuar edhe një kërkesë tjetër. Në DT kërkohet dorëzimi edhe i një ISO-CE për dezinfektuesit për sipërfaqe dhe për dezinfektuesit për duar. IRIS PHARM & Ardi Sh.P.K. ka dorëzuar një ISO-CE ku ceken vetëm dezinfektuesit për duar, por jo dezinfektuesi për sipërfaqe. Përveç kësaj, është kërkuar edhe autorizimi nga prodhuesi për këto dy pozicione, por edhe në këtë rast autorizimi është dorëzuar vetëm për njërin prej dezinfektuesve, kësaj radhe për dezinfektuesin për sipërfaqe, por jo për dezinfektuesin për duar.

Po ashtu, për tenderë që zhvillohen përmes procedurës me negocim, Ligji i prokurimit publik parasheh që të zhvillohen negociata me OE për ulje të çmimit, gjë që në rastin konkret nuk ka ndodhur. Pra, në Dosje të Tenderit nuk figuron asnjë dëshmi që AK ka bërë përpjekje që ta ulë çmimin e ofertuar nga GOE IRIS PHARM & Ardi.

Tenderi 7: Furnizim me mjete mbrojtëse kundër COVID-19

Komuna e Obiliqit ka vazhduar të blejë materiale mbrojtëse kundër COVID-19, mirëpo kësaj radhe përmes procedurës së hapur. Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar më 20 nëntor 2020, për të cilin janë pranuar gjashtë oferta. Oferta më e lirë në mesin e operatorëve të përgjegjshëm ka qenë ajo e kompanisë PRO MEDICAL Sh.P.K., me 48,408.55 euro.

Pas analizimit të tenderit është evidentuar kontraktimi i çmimeve të ndryshme për të njëjtin produkt dhe në të njëjtën paramasë. Kompania fituese në paramasën e përgatitur nga Komuna e Obiliqit, ka ofertuar me çmim të ndryshëm për dezinfektuesin e gatshëm për duar 1 litërsh, ku për Qendrën Kryesorë të Mjekësisë Familjare (QKMF) është kontraktuar çmimi 2.60 euro, ndërsa për Drejtorinë e Arsimit, 1.70 euro për të njëjtin produkt.

12 Ky ritenderim është bërë pasi procedura e tenderit në herën e parë ishte pezulluar përmes Vendimit mbi Pezullim të Aktivitetit të Prokurimit të datës 29.09.2021.

Figura 11 - Çmimi i dhënë për QKMF-në



4	Dezinfektues per duar te gatshem (permbajtja min.70% alkool)	Liter	2000	2.60	5,200.00 €

Figura 12 - Çmimi i dhënë për Drejtorinë e Arsimit



4	Dezinfektues per duar te gatshem (permbajtja min.70% alkool)	Liter	7953	1.70	13,520.10 €

Sikur të kontraktohej produkti në fjalë me të njëjtin çmim (1.70 euro) për QKMF-në edhe për Drejtorinë e Arsimit, buxheti do të ruhej për 1,800 euro. Duke pasur parasysh që është i njëjti autoritet kontraktues, komuna është dashur që ta hartojë një paramasë të vetme për dy njësitë, gjë e cila do ta evitonte këtë dallim në çmime.

Në ditën e nënshkrimit të kontratës, më 09 dhjetor 2020, është caktuar edhe menaxheri i kontratës. Në vendimin për caktimin e menaxherit është cekur që furnizimi duhet të kryhet brenda dhjetë (10) ditëve nga nënshkrimi i kontratës, pra me 19 dhjetor 2020 është kryer furnizimi. Mirëpo, vetëm dy ditë para kësaj date (17 dhjetor 2020), menaxheri i kontratës kishte përpiluar 'Planin e Menaxhimit të Kontratës', veprim i cili është dashur të bëhet menjëherë pas caktimit të tij si menaxher i kontratës, e jo ditën kur ka filluar dorëzimi dhe pranimi i mallit.

Përveç kësaj, gjatë analizimit të tenderit, është vërejtur që operatori i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë profesionale[13]. Në Dosje të Tenderit është kërkuar ndër të tjera edhe certifikata e numrit fiskal, mirëpo e njëjta nuk gjendet në ofertën e operatorit ekonomik fitues. Në raportin e vlerësimit të tenderëve nuk është evidentuar një gjë e tillë, ku në kolonën ku duhet të ceket se a është në pajtim apo jo me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, komisioni i vlerësimit e ka cekur si kusht të plotësuar.

Tabela 6 - Pjesë nga raporti i vlerësimit

Dokumenti i kërkuar	PRO MEDICAL Sh.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa nr.1 Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompletuar	Në pajtim
Kërkesa nr.2 Certifikata e numrit fiskal	Në pajtim
Kërkesa nr.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga AKPPM	Në pajtim

Sipas Ligjit të prokurimit publik,[14] AK gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, është dashur të kërkojë informata shtesë apo sqaruese. Përveç kësaj, edhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik[15] thekson që "Autoriteti kontraktues mund t'i ftojë operatorët ekonomikë për t'i plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe

13 Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 66.
14 Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 72.
15 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, neni 39, paragrafi 5: https://bit.ly/32byyct

dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të Ligjit të prokurimit publik, d.m.th. dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE". Ndërkaq, në rast kur OE dështon t'i përgjigjet AK-së brenda afatit kohor të përcaktuar, tenderi përkatës duhet të refuzohet.[16]

Tenderi 8: Furnizim me material higjienik kundër COVID-19 për institucionet publike

Komuna e Deçanit në prill të vitit 2021 ka publikuar një tender për furnizim me material higjienik për COVID-19, në vlerë prej 120,000 euro. Në këtë tender kanë ofertuar katër kompani: Ardi Sh.P.K.; N.T.Sh. Gipa; Matkos Pharm Sh.P.K. dhe N.Sh.T. MADE-KOS. Si fituese është shpallur kjo e fundit, MADE-KOS, oferta e të cilës ka qenë 84,986.50 euro.

Kompania fituese, gjatë tenderimit për këtë aktivitet të prokurimit ka përdorur dy emra, emrin e vjetër N.Sh.T. MADE-KOS dhe emrin e ri MADEKOS Sh.P.K. Kjo kompani statusin e saj në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) e ka ndryshuar më 12 prill 2021, pra 10 ditë para ditës të cilën ka ofertuar për tenderin në fjalë.

Figura 13 - Burimi ARBK – Statusi i kompanisë N.T.Sh. MADE-KOS

Statusi në ARBK	Shuar
Data e shuarjes	12/04/2021

Meqenëse një prej kërkesave në DT ka qenë edhe sigurimi i tenderit[17], të cilin kompania në fjalë e ka dorëzuar si N.Sh.T. MADE-KOS, e i cili sigurim mban datën 21.04.2021, është dokument jovalid. Një dokument i tillë nuk është dashur të pranohet, pasi është nxjerrë pas shuarjes së kompanisë si biznes, dhe si emër i biznesit nuk mund të përdoret më. Përveç kësaj, në procesverbalin e hapjes së këtij aktiviteti të prokurimit, figuron si N.Sh.T. MADE-KOS, ndërsa kontrata është nënshkruar si MADEKOS Sh.P.K.

Kjo kontratë është kornizë, si kontratë njëvjeçare dhe vlen deri më 10.05.2022[18]. Nënshkrimi i kontratave kornizë në kohën kur çmimet gjithnjë e më shumë ulen për shkak të konkurrencës, konsiderohet veprim i menduar jo mirë nga autoriteti kontraktues. Një prej produkteve që komuna ka kontraktuar nga kjo kompani është edhe maska ffp2. Kjo maskë në fillim të pandemisë ka pasur çmime të lartë, përkatësisht në mes të 8 – 12 euro. Sipas Doganës së Kosovës, kjo lloj maske ishte importuar për 2.50 euro[19].

Ndërkaq, tani pas gati dy vitesh që Kosova po përballet me pandeminë COVID-19, çmimet kanë rënë dukshëm. Aktualisht, një maskë e tillë në treg kushton rreth 0.60 euro, ndërkaq çmimi i kontraktuar nga komuna përkatëse është 1.20 euro. Në këtë rast, komuna do ta blejë një maskë me një çmim më të lartë sesa që është në treg, vetëm pse ka lidhur një kontratë kornizë dhe duhet t'i përmbahet deri në skadim apo deri në 70% të ekzekutimit të saj, ashtu edhe siç parashihet me ligj.

16 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, neni 39.7.
17 Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender.
18 Kontrata është nënshkruar më 11.05.2021.
19 Shih videon e punuar nga D+ ku ceket edhe çmimi i importimit të kësaj maske: https://bit.ly/3crqeXQ

Tenderi 9: Furnizim me miell për familjet në kushte të rënda ekonomike të shkaktuara nga pandemia

Komuna e Malishevës në fund të vitit 2020 ka iniciuar procedurën e prokurimit për t'u furnizuar me miell familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga pandemia COVID-19, familje këto që jetojnë në territorin e Komunës së Malishevës.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë katër operatorë ekonomikë sipas tabelës në vijim. Vlera e parashikuar për këtë tender ka qenë 20,000.00 euro.

Tabela 7: Operatorët ekonomikë që ofertuan për këtë tender dhe vlera e ofertave të tyre

Nr.	Operatori ekonomik	Vlera e ofertës
1	Dauti Komerc Sh.P.K.	18,000.00 euro
2	Gashi 4 Compani Sh.P.K.	17,700.00 euro
3	N.P.Sh. Vëllezëri Telaku	18,480.00 euro
4	Viva Fly Sh.P.K.	18,000.00 euro

Komuna e Malishevës pas vlerësimit të ofertave ka shpërblyer me kontratë OE Gashi 4 Compani. Kontrata është lidhur më 30 dhjetor2020, në vlerë prej 17,700.00 euro si oferta më e lirë.

Meqë tenderi në fjalë ka të bëjë me miellin, si përbërësin kryesor për përgatitjen e bukës, autoriteti kontraktues është dashur të listojë si kërkesa edhe dëshmi për cilësinë e miellit. Me legjislacionin e Kosovës[20], çdo lloj mielli që del në treg, duhet t'i kalojë edhe testet e cilësisë, kontroll të cilin e bënë Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (AUV). Në këtë drejtim, AK është dashur të kërkojë patjetër qoftë ndonjë licencë për përpunim të drithërave, teste laboratorike apo ndonjë dokument tjetër përmes së cilës dëshmohet cilësia e miellit.

Nëse AK nuk ka kërkuar ndonjë dëshmi vetëm për mos ta dëmtuar konkurrencën, AK është dashur së paku të kërkojë listë të kontratave të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit, po ashtu duke i dëshmuar përmes kontratave, referencave apo raporteve të pranimit të mallit. Lidhja e kontratave të tilla, duke mos pasur të dhëna për cilësinë e miellit, në rastin më të keq mund ta rrezikojë shëndetin publik, gjë që përveç mbi OE, përgjegjësia kryesore bie te autoriteti kontraktues, në këtë rast komuna e Malishevës.

20 Ligji nr.03/L-016 për Ushqimin dhe Rregullorja nr.18/2016 për Regjistrimin dhe Aprovimin e Operatorëve të Biznesit për Ushqim.

Tenderi 10: Furnizim me pako ushqimore/higjienike për familjet në kushte të rënda ekonomike të shkaktuara nga pandemia

Komuna e Malishevës në të njëjtën kohë (dhjetor 2020), ka iniciuar procedurën për furnizim me pako ushqimore/higjienike për familjet me kushte të rënda ekonomike të shkaktuara si pasojë e COVID-19.

Në këtë procedurë të prokurimit kanë marrë pjesë gjashtë OE sipas tabelës në vijim. Vlera e parashikuar për t'u shpenzuar për këtë tender është 40,000.00 euro, ndërkaq me kontratë është shpërblyer OE N.T.Sh. Tradita Tregtare me 32,355.00 si oferta e përgjegjshme më e lirë.

Tabela 8 – Operatorët ekonomikë që kanë ofertuar për këtë tender dhe vlera e ofertës

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertës
1	Dauti Komerc Sh.P.K. & Dauti Komerc AD	32,420.00 euro
2	Beni Dona Plast Sh.P.K.	32.21 euro
3	N.T.Sh. Tradita Tregtare	32,355.00 euro
4	Viva Fly Sh.P.K.	29,950.00 euro
5	ATC Sh.P.K.	35,120.00 euro
6	N.T.P. A&B Market	34,280.00 euro

Mirëpo, OE Viva Fly ka rezultuar si ofertues më i lirë se OE fitues, mirëpo është eliminuar për shkak të gabimeve në llogaritje të pozicionit nr.16, ku biberin me sasi 0.5 kg e ka shumëzuar me çmimin 1.15 ndërsa si rezultat ka nxjerrë 1.25 euro, që do të duhej të ishte 0.575 euro. Ndërsa, Beni Dona Plast Sh.P.K. ka shtuar një pozicion ku ka pasur mospërputhje ndërmjet çmimit për pako dhe çmimit total të pakove.

AK për një pako ka kërkuar 19 artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe higjienikë. Duke u bazuar në faturat që janë dorëzuar, vërehet që blerja është bërë me pako. Në faturë figuron "furnizim me pako ushqimore COVID-19", pra artikujt nuk janë blerë veç e veç, por si pako.

Figura 14 – Fatura, përshkrimi i mallit

Email: tradita.tregtare@gmail.com Data: 28-12-2020

Nr.	Emërtimi i Mallit	Njesia	Sasia	Vlera pa TVSH	TVSH %	Vlera e TVSH	Çmimi për njesi	Vlera Totale me TVSH
1	Furnizim me pako ushqimore Covid 19	Pako	700	19.193,64 €	18%	3.454,86 €	32,36 €	22.648,50 €

	Baza per TVSH	TVSH	Total me TVSH
8%	0,00 €	0,00 €	0,00 €
18%	19.193,64 €	3.454,86 €	22.648,50 €
Totali:	19.193,64 €	3.454,86 €	22.648,50 €

Per Pagesë: 22.648,50 €

Siç mund të vërehet, fatura nuk dëshmon që në pako janë përfshirë të gjithë artikujt. Dorëzimi i pakove si të tilla vështirëson edhe punën e menaxherit të kontratës, ngase i njëjti duhet ta verifikojë çdo pako nëse i përmban apo jo artikujt e kontraktuar. Në këtë rast, fatura do të duhej të lëshohej për secilin artikull, ngase kontrata është lidhur për secilin artikull.

Vlenë të ceket se komuna e Istogut në prill të vitit 2020 ka lidhur kontratë të ngjashme, mirëpo nuk ka bërë blerje për pako, por ka blerë secilin produkt siç është kërkuar në paramasë, ku pastaj produktet janë pozicionuar në pako, sipas kërkesës dhe nevojës së shpërndarjes.

Figura 15 – Fatura, përshkrimi i mallit

08.12.2020 08.12.2020 L01

1	228	MIELL EURO VER TIP 400 25KG	75.00	COPE	9.72	8.00	10.50	787.50
2	3902581860127	SHAMP.DUAR KOKOS 12 1L FRESH	75.00	Copë	0.74	18.00	0.87	65.25
3	8714789700052	SAPUN PALMOLIV ALMOND 6/90GR	150.00	Copë	0.31	18.00	0.36	54.00
4	6001067021605	PASTE HERBAL 12/50ML	75.00	Copë	0.51	18.00	0.60	45.00
5	8690637895166	DOMESTOS 750ML 20/1	75.00	Copë	0.92	18.00	1.08	81.00
6	3902720960091	FASULE EDONA- 1KG	75.00	Copë	1.67	18.00	1.97	147.75
7	8005121000535	MAKARON DIVELLA NR.53 24 500GR	150.00	Copë	0.59	8.00	0.64	96.00
8	5319990534705	ORIZ ANDREA 10/1KG	75.00	COPE	0.81	8.00	0.87	65.25
9	3870114001708	PASHTETE PULE ARGETA 95GR*12	450.00	Copë	0.64	18.00	0.75	337.50
10	3850105124821	FAKS BIOAKTIV FLOWER FRES4 3KG	75.00	Copë	2.34	18.00	2.76	207.00
11	3900013030018	KRIPE KUZHINE E JODIZUAR 14/1KG	75.00	Copë	0.24	8.00	0.26	19.50
12	3901843660055	SHEQER KRISTAL AGROKOR 1/1	300.00	Copë	0.55	18.00	0.65	195.00
13	3902581860776	BRILIANT DET.ENVE 16/1L	75.00	Copë	0.69	18.00	0.82	61.50
14	3900372010034	QUMESHT VITA 3.2 12 1L	225.00	Copë	0.81	8.00	0.88	198.00
15	3903976460052	VAJ PREMIUM 1L/15	225.00	Copë	0.86	18.00	1.01	227.25
16	8714789880471	SHAMPO PALMOLIV OLIVE 6/500ML	75.00	Copë	0.83	18.00	0.98	73.50

SubTotal: $2,346.59

Frieght: $.00

Vlera pa TVSH : 2,346.60

TVSH : 314.40

Vlera per pagese: 2,661.00 EUR

Normat Tatimore	Baza	TVSH	Vlera
TVSH e llogaritur 0%	0.00	0.00	0.00
TVSH e llogaritur 8%	1,079.86	86.39	1,166.25
TVSH e llogaritur 18%	1,266.74	228.01	1,494.75

Kjo formë e blerjes nuk duhet të bëhet precedent për asnjë AK, pasi lë hapësirë për keqpërdorime, siç mund të jetë mospërfshirja e gjithë artikujve të kontraktuar.

Përfundim dhe rekomandime

Në bazë të situatës së përshkruar më sipër, mund të përfundohet që autoritetet kontraktuese kanë përdorur në masë të madhe pandeminë si arsyetim për përdorim të procedurave urgjente në prokurim publik. Nëpunësit civil në zyrat e prokurimit të autoriteteve kontraktuese (në nivel qendror dhe lokal) nuk i kanë zbatuar rregullat e prokurimit publik ashtu siç kërkohet me ligj. Në këtë mënyrë, kjo ka rezultuar në menaxhim të keq të procedurave të prokurimit publik dhe për pasojë shpenzim jo të duhur të parasë publike.

Pra, në bazë të këtij përfundimi por edhe të tërë situatës së përshkruar në raport, Demokraci Plus (D+) ka këto rekomandime për autoritetet kontraktuese:

1. Procedura e negociuar të përdoret nga autoritetet kontraktuese vetëm në rastet e parapara me ligj dhe të emergjencave;

2. Mos të vendosen kërkesa të panevojshme, sidomos ISO-ve, të cilat nuk përkojnë me natyrën e tenderëve dhe që dëmtojnë konkurrencën;

3. Çdo kërkesë që listohet në dosje të tenderëve, duhet të respektohet dhe të dorëzohen dëshmi përkatëse, gjë që komisionet vlerësuese duhet t'i analizojnë dhe ta shpërblejnë me kontratë vetëm operatorin e përgjegjshëm;

4. Autoritetet kontraktuese nuk duhet të vendosin kërkesa minimale ndaj operatorëve ekonomikë në rastet kur tenderët janë me vlerë të lartë, të ndërlikuar për nga natyra dhe që kërkojnë profesionalizëm dhe eksperiencë,

5. Të bëhet hulumtimi i tregut për çdo mall që blihet apo për çfarëdo shërbimi apo pune që kërkohet më herët se sa shpallet tenderi në mënyrë që të ketë menaxhim më të mirë në shpenzim të parasë publike;

6. Të evidentohen çmimet jonormalisht të ulëta dhe të kërkohen sqarime me shkrim nga operatorët ekonomikë përkatës për çmimet e ofruara, në mënyrë që të eliminohen problemet gjatë implementimit të kontratës;

7. Personat përgjegjës për menaxhim të kontratës të jenë më të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm në mbikëqyrje të OE-ve.

Funded by
the European Union

Democracy
Plus